

ANAGNOSTI - MJESHTËR I KINEMASË SHQIPTARE

Nga: Abaz T. Hoxha

Pedagog, Studiues dhe Historian i Kinemasë

Kinematografia shqiptare ka patur mjaft arritje, janë prodhuar mbi 300 filma artistikë të gjinive dhe metrazheve të ndryshme duke u krijuar një traditë në kulturën dhe artin shqiptar. Shumë filma shqiptarë janë pritur me interes të veçantë jo vetëm brenda vendit por edhe në Festivale të ndryshme ndërkombëtare ku janë shfaqur dhe janë nderuar me shumë çmime si në të kaluarën ashtu edhe veprat e kineastëve të rinj të viteve të fundit. Kinemaja, kultura dhe arti shqiptar krenohen me këta krijues të kësaj tradite të re që kanë ngritur lart emrin e Shqipërisë edhe jashtë saj.

Ndër këta kineastë, themelues të këtij arti të ri, që hodhën bazat e kinematografisë sonë ka shkëlqyer gjithmonë emri i nderuar i Artistit të Popullit, fituesit të disa çmimeve të para në Festivale kombëtare e Ndërkombëtare, mjeshtër të ekranit, Dhimitër Anagnosti.

E kam ndjekur hap pas hapi dhe me shumë interes gjithë krijimtarinë e këtij mjeshtri të madh të kinemasë shqiptare. Mbase mbaroi studimet e larta për operator në Institutin e njohur Kinematografik të Moskës themeluar nga një prej mjeshtërve të kinemasë Sovjetike Lev Kuleshov që në vitin 1919, ai e filloi karrierën në kinematografinë shqiptare si operator nëpërmjet xhirimit në film të ngjarjeve të ditës, kronikave dhe filmave dokumentarë. Dy nga filmat e tij të parë dokumentarë që u dalluan për mjeshtëri në anën figurative ishin “Gjirokastra” dhe “Gurët dekorativë” ky i fundit i pari film dokumentar me ngjyra që u përpunua në laboratorin e Kinostudios “Shqipëria e re”. Paralelisht, punoi si operator në filmat e parë artistikë “Debatik”(1961) dhe “Toka e jonë”(1964) të dy me regji të H. Hakanit.

Por kinematografia shqiptare po shkonte drejt rritjes dhe për këtë i duheshin kuadro të shkolluara me kulturë dhe të afta, prandaj edhe ai, si një mjeshtër i kamerës, kompozicionit, me frymëzim poetik prirje të theksuara artistike që i kishte dëshmuar që në shkollën e mesme “Ali Demi” në Vlorë, kaloi me guxim edhe në funksionin e regjisë dhe së bashku me V. Gjikën xhiruan filmin e tyre të parë si regjisor “Komisari i dritës” (1966) i cili mbeti një nga gurët themelues të kinemasë shqiptare për vlerat e tij regjisoriale të kamerës dhe subjektin që trajtonte të realizuar me mjeshtëri.

Por vlerat e tij si një regjisor me një t’ardhme të madhe dhe si një mjeshtër i vërtetë i ekranit u dukën që në filmin e tij të parë të pavarur “Duel i heshtur”(1967). Ky ishte një film ku dolën në pah përpjekjet e suksesëshme të regjisorit të ri për të depërtuar në psikologjinë e personazheve dhe ndonse i mbështetur në katër personazhe (tre nga të cilët aktorë të rinj), ka një ngarkesë të fuqishme dramatike dhe emocionale dhe megjithëse ngjarja zhvillohet në bordin e një motovedete në det të hapur, të bën ta ndjekësh me interes edhe kur e ke parë disa herë. Ishte ky një shëmbëll i shkëlqyer shqiptar që nuk mbetej pas filmit të njohur francez “Maria Oktobër” (ngjarjet e të cilit zhvillohen në një dhomë) ndonse ky i fundit interpretohet nga 10 aktorë me shumë përvojë që bënin pjesë në elitën e interpretimit të kinemasë franceze të asaj periudhe.

Dhe Dh. Anagnosti është dëshmitari më i qartë i përkushtimit dhe devotshmërisë. Ai u dallua për vepra të suksesshme në gjithë krijimtarinë e tij si një mjeshtër i detajit dhe gjuhës së tij të veçantë duke i dhënë çdo vepër vullën e tij personale.

Kinemaja u nda nga teatri pikërisht nga fakti se, ndërsa teatri flet kryesisht me dialogun, ku zëri zë vendin kryesor, kinemaja është një art vizual ku figura është themeloria. Jo më kot studiues të ndryshëm e kanë përcaktuar kinemanë si një art kryesisht visual, si një fotografi në lëvizje, por që dallon thelbësisht nga ajo. Përfaqësonjësit e “Valës së re” franceze, në fundin e viteve ’50, në përpjekjet e tyre për të ngritur rolin e kinemasë si një art kryesisht viziv, i jepnin përparësi imazhit kinematografik. Kinemaja e vërtetë kërkon figurë të pastër dhe shprehëse, dialog të kursyer, konçiz, që të shprehë ide me sa më pak fjalë, që të japë mesazhe dhe jo të shoqërojë thjesht personazhet dhe ngjarjet. Kinemaja është gjithashtu një art kompleks, një art sintezë ku përfshihen të gjitha artet të cilat duhet të bashkëveprojnë në unizon me njëra tjetrën.

Elemente të tjera që përcaktojnë gjuhën e filmit janë përdorimi funksional i zhurmave, muzika, skenografia, kostumografia dhe padyshim montazhi ku i jepet filmit të ardhshëm portreti,

mesazhi. Në montazh krijohen emocionet, rritet shkalla e dramaticitetit të veprimit filmik etj. Të gjithë këto elementë duhet të harmonizohen, të veprojnë në unizon, secili ka rolin e tij të veçantë, secili duhet të plotësojë idenë me mjetet e tij të veçanta. Dhimitër Anagnosti është një mjeshtër i vërtetë i harmonizimit të komponentëve dhe ka një stil të tij të veçantë për dhënjen e mesazheve.

Çdo kinematografi kombëtare jep ndihmesën e saj në të përgjithëshmen, në vizionin e kinemasë botërore, seicila kinematografi duhet të flasë me mjetet e saj të veçanta. Filmi duhet të japë botën shpirtërore, psikologjinë e vendit të tij.

Kinemaja botërore nuk ka nevojë që p, sh filmi shqiptar të imitojë të tjerët, të përpiqet ti japë botës mesazhe dhe mjete shprehjeje që i ka huajtur nga ata vetë, ajo duhet të japë mesazhet e vendit dhe popullit të tij.

Filmat e Dh. Anagnostit bien erë Shqipëri, kanë taban të fortë kombëtar. Ai ka vërtetuar me krijimtarinë e tij se njeh thellësisht psikologjinë, humorin, traditën dhe nuk përpiqet të sajojë, të huazojë nga të tjerët por i përdor të gjithë këto elementë me mjeshtëri duke i dhënë filmave vizionin e tij personal. . Ai është regjisori që flet me një gjuhë të veçantë, me stilin, gjuhën, psikologjinë e tij Filmat e tij, edhe duke mos u parë titujt, dallohen qartësisht se janë të Anagnostit. Ai ka krijuar gjuhën e tij të shprehurit, gjuhën e Anagnostit. Këtë e vërtetojnë të gjithë filmat e tij që nga *“Dueli i heshtur”*, *“Plagë të vjetra”*, *“Malet me blerim mbuluar”*, *“Lulëkuqet mbi mure”*, *“Në shtëpinë tonë”*, *“Përrallë nga e kaluara”*, *“Kthimi i ushtrisë së vdekur”* etj.

Ai është një mjeshtër i vërtetë në përdorimin e humorit të popullit që e përdor me mjeshtëri, me masë dhe me vend për të dhënë ide të koncentruara, asgjë ashtu kot por me synime të caktuara dhe e udhëheq spektatorin natyrshëm në rrjedhjen e ngjarjeve. Gjithë filmat e Anagnostit kanë taban kombëtar, nuk huan nga të tjerët, don ti japë spektatorit shqiptar dhe të huaj botën shqiptare dhe këtë e ka arritur me sukses në të gjithë filmat e tij. Në të gjithë filmat e Anagnostit ndihet një stil i veçantë, ai të fut natyrshëm dhe pa u kuptuar në brendësi të ngjarjes, dramën e personazheve, shpesh me detaje humoristike derisa sikur të tërheq përdore dhe të fut gradualisht në ngjarje dhe si pa e kuptuar ti bëhesh personazh pjesëmarrës.

Ai është gjithashtu një mjeshtër i e dialogut konçiz duke eliminuar fjalimet dhe deklamimet si p, sh, me tre plane dhe dy fjalë jep idenë e padrejtësive të zbatuesve të ligjeve me frazën e njohur *“ligji dhe Maliqi”*, etj.

Skrupuloziteti i tij për një dialog të spikatur dhe në një gjuhë të pastër shqipe është mjaft i dallushëm. Bashkëshortja e tij, aktorja e njohur Roza Anagnosti tregon: *...Dhimitri është shumë rigoroz në përdorimin e gjuhës shqipe. Kur merrja ndonjë rol në teatër ai më bënte ta përsërisja disa herë dialogun që të ishte i pastër dhe jashtë dialektalizmave dhe barbarizmave. Nuk të lëshon aspak pe në përdorimin e gjuhës”...*

Ai është mjeshtër në përdorimin e efekteve zanore dhe të planit të dytë si një element i rëndësishëm dramatik që u jep një shkëlqim të veçantë filmave të tij. Le të marrim p, sh, filmin *“Lulëkuqet mbi mure”*. Jepet mësuesja (Pavlina Mani) duke ngjitur shkallët, nga një klasë mësimi vjen e deformuar mësimi i italishtes... il popolo italiano... ajo shkon më tej dhe përgatitet të dirigjojë, por, sapo fillon në sfond dëgjohet guzhinjeri duke kënduar... Te rrapit në mashkullorë... pra, sfidon këngën italiane, etj. Po kështu në filmin *“Përrallë nga e kaluara”*... burri dhe gruaja (Robert Ndrenika dhe Hajrie Rondo) bisedojnë për martesën e pazakontë të djalit 14 vjeçar. Në sfond dëgjohen pëshpërime thashethemesh të grave të lagjes e pak më tej dëgjohet zhurma e shkëmbinjve që rrukullisen nga kodra nga i dashuri i Marigosë (Elvira Diamandi). Të gjitha këto japin idenë kundërshtimit, revoltës për këtë padrejtësi dhe zakon prapanik të martesës të një fëmije 14 vjeçar me një vajzë të dashuruar me Trimin (Xhevdet Ferri).

Anagnosti është gjithashtu mjeshtër në zgjedhjen e skenografisë dhe kostumografisë me skrupulozitet, e mjediseve reale në dekor dhe natyrë, e dialogut dhe psikologjisë së popullit dhe kjo dëshmohet në të gjitha filmat e tij e sidomos në *“Gurët e shtëpisë sime”*, *“Përrallë nga e kaluara”*, ose *“Kthimi i ushtrisë së vdekur”*, pa përmendur këtu filmin e fundit që ka arritur në përsosmëri.

Anagnosti nuk është njeri i bujshëm në jetë por ai është i dashuruar thellësisht me vendin e tij dhe si një artist shumëdimensional e përdor edhe natyrën e pejsazhin si një element të

rëndësishëm në shërbim të idesë dhe dramaturgjisë. Në filmat e tij, dhe veçanërisht në atë të fundit, ai kalon nga pejsazhet përralore, lirike, baritore që zbresin deri në kaltërsinë e detit Jon të cilat, të shoqëruara me këngët e bukura lirike të krahinës së Labërisë, plotësojnë imazhin e frymës poetike të këtij populli. Herë të tjera ai i jep pejsazhin si një element i fuqishëm dramatik që është pjesë përbërëse e këtyre njerëzve duke na dhënë majat e thepisura dhe shkëmbenjtë gjigandë të mbuluara edhe me një vello mjergulle që bëhen një element i rëndësishëm plotësues dhe shprehës në harmonizimin e komponentit natyrë me elementët e tjerë të filmit.

Dashurinë e pakufishme për vendin e tij ai e jep deri te titujt e thjeshtë të filmave të tij si në *“Gurët e shtëpisë sime”* ose *“Malet me blerim mbuluar”* ku drama dhe lirizmi, poezia, bashkëjetojnë. Nga njëra anë drama e kombit dhe e këtyre luftëtarëve të lirisë që sfidojnë vështirësi të panumurta duke shoqëruar Lilo Laben - një partizane që ka humbur këmbën - dhe nga ana tjetër titulli, natyra dhe pejsazhet e bukura të maleve shqiptare, këto male të bleruar që mbushin me frymëzim dhe u japin forcë dhe optimizëm në jetë këtyre luftëtarëve të lirisë. Anagnosti është një poet i ekranit dhe kjo frymë e tij poetike e ka burimin te dashuria e tij e pakufishme për vendlindjen. Në filmat e tij ai gërsheton këngën labe, pejsazhin e bukur dhe humorin e spikatur popullor që ia ngrenë vlerat dhe i bëjnë të veçantë filmat e tij.

Në të gjitha filmat e Anagnostit të bie në sy mjedisi, skenografia dhe kostumografia e përsosur e krahinës së tij, ndonëse nuk ka jetuar gjatë atje por ai e ka studjuar dhe e jep me detaje. Ai i ka rrënjët të thella në popullin e krahinës së tij, njeh në detaje psikologjinë dhe humorin, folklorin dhe i jep me një realizëm të paparë që është për t’u admiruar. Ai është një regjisor i madh shqiptar

Anagnosti është një mjeshtër i vërtetë në zgjedhjen e aktorëve dhe bën një punë të lodhshme e këmbëngulëse derisa arrin të bindet që ai është më jetësori, më i natyrshmi për rolin e tij, që nuk futet në rol i imponuar nga jashtë se e don regjisorin, por se kështu e kërkon, subjekti, drama. Ai bën një punë stërmunduese që të stërvitë aktorin për të qënë sa më real dhe i natyrshëm dhe kjo ka bërë që personazhet e tij të mbeten në mend.

Në dhjetra shkolla, anëkënd Shqipërisë e kërkoi Gjinon në *“Përrallë nga e kaluara”* deri sa u bind plotësisht se ai do të përballonte rolin dhe do të ishte i besushëm, siç u bë në të vërtetë. Por personazhi i Gjolekës në filmin e fundit është një personazh shumë më kompleks, që vepron në rrethana të tjera shumë më të komplikuar, një fëmijë i zgjuar që e don shumë babain e tij, paçka se ai sillet në mënyrë të vrazhdë ndaj tij. Ai e ndien thellë në qënien e tij se babai nuk e ka me të keq, por se don të kalisë një *“burrë”* të fortë që të jetë në gjendje për të pëballuar sfidat e jetës dhe se ai vetë ka thellë në shpirt një brengë që e trajton në atë mënyrë djalin e tij që e don aq shumë, por që e ndjek zakoni i trashëguar nga babai i tij.

Këtë e ka vërtetuar në të gjitha filmat e tij prandaj personazhet e filmave të tij janë aq të natyrshëm dhe jetësorë që nga *“Lulëkuqet mbi mure”* dhe deri në filmin e fundit *“Gjoleka i biri i Abazit”*.

Personazhet e tij të mbeten në mend për shumë kohë mbasi janë personazhe të goditur dhe realë, që nga katërshja kapter Rahmiu, Skënder Guri, Islami, Bepini (*Duel i heshtur*, 1967), çifti doktorëshë Vera - Gjini (*Plagë të vjetra*, 1969), Kabo Dalipi, Jaho Cani, Safa Ymeri, Lilo Labja (*Malet me blerim mbuluar*, 1971), mësuesi, drejtori, kujdestari, ekonomati dhe galeria e fëmijve (*Lulëkuqet mbi mure*, 1976), Miri - Ana (*Në shtëpinë tonë*, 1979), Vangjeli, Tana, Marigo, Gjino (*Përrallë nga e kaluara*, 1987), Gjenerali, Prifti, plaka Nicë (*Kthimi i ushtrisë së vdekur*, 1989), e deri te Gjoleka - Abazi në filmin e fundit.

Anagnosti është dalluar si një regjisor se nuk fillon asnjë punë pa u bindur plotësisht se do ta shpjerë atë drejt suksesit, bën një punë të madhe stërmunduese dhe seleksionuse, për typ mirë çdo detaj të skenarit dhe mbasi bindet se në atë është seleksionuar çdo gjë e tepërt e parazitë e panevojshme, çiban, atëhere nis punën e bindur në suksesin.

Anagnosti është dalluar edhe si një skenarist me një stil të veçantë dhe ide konçize, autor i mbi 12 skenarëve, një artist i kompletuar në letërsi, kamera, regji dhe skenografi. Filmat e tij dallohen për mendimin e thellë regjisorial dhe një gjuhë të pastër filmike. Filmat e tij janë të zhveshur nga elementët parazitare të jashtëm dhe pa funksion.

Anagnosti është një njeri i thjeshtë e pa bujë, që nuk flet asnjëherë për vete dhe kjo modesti e bën atë një figurë më të madhe në jetë e krijimtari që duhet marrë shëmbull nga gjithkush. Ai ka qënë dhe është gjithmonë një njeri i mendimit të lirë, ka luftuar gjithmonë, edhe në kohët më të vështira, për të mbrojtur idetë e tij.